



AKT - THEMELIMI

"UNION BANK" sh.a.

Sot me date 04/08/2004 ne Tirane, te nenshkruarit:

1. **Z.Edmond LEKA**, i biri i Vlashit, lindur me 17.05.1963 ne Tirane dhe banues po aty ne Rr."Lidhja e Prizrenit", Pall. 12, Shk.10, Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 0325057
2. **Z.Niko LEKA**, i biri i Vlashit, lindur me 31.03.1961 ne Tirane dhe banues po aty ne Rr. "Sulejman Delvina", Pall. 29, Shk.15/89 Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 0229907
3. Shoqeria tregetare **"Unioni Financiar Tirane" sh.p.k.**, krijua si person juridik me vendimin e Gjykates te Rrethit Tirane Nr.9406 date 06.03.1995, perfaqesuar ketu ne baze te Vendimit te Asamblese te Ortakeve noterizuar me Nr. 3717 Rep. Nr. 1094 Kol dt. 10.09.2004 nga Notere Eriketa Kokoli, nga Z.Edmond Leka, i Biri i Vlashit, lindur me 17.05.1963 ne Tirane dhe banues po aty ne Rr. "Lidhja E Prizrenit", Pall.Pall. 12, Shk. 10, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 0325057

Bazuar ne ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" si dhe ligjin nr. 8365 date 02.07.1998 "Per bankat ne Republiken e Shqiperise" me vullnetin e tyre te lire vendosen :

Neni 1

Te themelojne shoqerine anonime pa oferte publike, me emertimin:

"UNION BANK" sh.a.

Banka eshte person juridik privat. Keshilli i Bankes se Shqiperise i ka dhene Bankes miratimin paraprak te licences ne Vendimin nr.877, date 15/02/05, ne zbatim te nenit 6, pika 6.4 te rregullores "Per dhenien e licences per te ushtruar veprimtari bankare ne Republiken e Shqiperise" (referuar ne Ligjin nr. 8365 date 02.07.1998 "Per bankat ne Republiken e Shqiperise" neni 10).

Neni 2

Selia e Bankes do te jete ne Bl. "Zogu I" Pallati 13 katesh, perballe Stacionit te Trenit, Tirane Shqiperi.

Banka me Vendim te Keshillit Drejtues e me miratim nga Banka e Shqiperise, mund te hape filiale ne te gjithë teritorin e Republikes te Shqiperise.

Banka me Vendim te Keshillit Drejtues e me miratim nga Banka e Shqiperise, mund te hape dege, agjensi ose zyra perfaqesimi jashte teritorit te Republikes te Shqiperise.

Neni 3

Veprimtaria e Bankes do te jete e pakufizuar ne kohe.

Neni 4

Objekti i veprimtarise te Bankes eshte perfshirja dhe kryerja ne Shqiperi dhe jashte Shqiperise, e te gjithë veprimtarive (transaksioneve) bankare qe jane te lejushme ne perputhje me ligjin Nr.8365 date 02.07.1998 "Per bankat ne Republiken e Shqiperise" dhe akteve te tjera nenligjore qe regullojne veprimtarine bankare.

Ne perputhje me licencen e mare nga Banka e Shqiperise, Banka ka te drejte :

1. Te pranoje dhe te grumbulloje depozita bankare
2. Te jape kredi
3. Te mare hua mjete financiare dhe te bleje ose te shese per llogari te saj apo per llogari te klienteve:
 - a) instrumente te tregut te parave
 - b) letra me vlere te borxhit
 - c) kontrata te se ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option) qe lidhen me letrat me vlere te borxhit ose me normat e interesit ose
 - d) instrumentet e normes te interesit
4. Te ofroje sherbimin e pagesave dhe te arketimeve
5. Te emetoje, te pranoje dhe te administroje mjete te pagesave
6. Te ndermjetoje per transaksionet monetare (duke perfshire valutat)
7. Te ushtroje qirane financiare
8. Te ofroje sherbimin e kasave te sigurimit
9. Te ofroje garanci bankare dhe garanci te tjera
10. Te sherbeje si agjente ose keshilltare financiare (ketu nuk perfshihen sherbimet e parashikuara ne piken 3/a dhe 3/b te nenit 26 te Ligjit "Per bankat ne Republiken e Shqiperise")
11. Te ushtroje veprimtari te tjera bankare dhe financiare te percaktuara me akte nenligjore nga Banka e Shqiperise.



Ne perputhje me licencen e mare nga Banka e Shqiperise banka ka te drejte te beje edhe kembimin e valutes, duke perfshire edhe kontratat e se ardhmes (futures) per kembime valutore.

Ne perputhje me licencen e mare banka ushtron edhe :

1. sherbime besimi (trust), perfshire pa kufizim, investim dhe administrimin e fondeve te besuara (fiduciare)
2. sherbime si administruese e portofolit te investimit ose keshilltarit per investimet
3. sherbime per neneshkrimin dhe shperndarjen e letrave me vlere te borxhit dhe te pronesise, si dhe tregetimin e letrave me vlere te pronesise per llogari te saj ose te klienteve ,sipas kufizimeve te parashikuara ne nenin 33 te Ligjit "Per bankat ne Republiken e Shqiperise"

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar Banka mund te kryeje cdo transakcion lidhur me pasuri te lutjeshme ose te palutjeshme, cdo aktivitet tregetar, financiar, qiradhenie apo hipotekimi, i cili vleresohet i dobishem apo i nevojshem nga Drejtoria per aritjen e qellimeve te Bankes. Gjithashtu banka mund te kryeje aktivitete publikimi dhe te reklames, mund te neneshkruaje letra me vlere dhe te leshoje garanci ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi.

Banka ka te drejte te bashkepunoje me persona juridike ose fizike ose me cilindo tjetër shoqeri, brenda vendit ose jashte vendit.

Neni 5

Kontributet per themelimin e shoqerise

1. Kontributet ne para

Ato sillen ne para dhe depozitohen konform ligjit ne nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim, ne nje banke te nivelit te dyte, nga aksioneret themelues si me poshte:

Edmond LEKA 200.000 (dyqindmije) euro

Niko LEKA 200.000 (dyqindmije) euro

"Unioni Financiar Tirane" sh.p.k 7.600.000 (shtatemilion e gjashteqind mije) euro

2 -Kontributi ne natyre

Asnje prej aksionereve nuk sjell kontribute ne natyre.

3 -Totali i kontributeve:

Kontributet totale jane 8.000.000 (tete milion) euro, ne para.

Neni 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte 8.000.000. (tete milion) euro.

Ai ndahet ne 800.000 (teteqind mije) aksione me vlere nominale nga 10 (dhjete) euro secili.

Themeluesit deklarojne se kapitali themeltar i percaktuar ne paragrafin e pare te ketij neni eshte neneshkruar dhe paguar prej tyre si me poshte:

7.000.000 (shtate milion) euro ne momentin e paraqitjes te kerkeses per regjistrim ne gjykate.

1.000.000 (nje milion) euro brenda afatit limit te vendosur nga Banka e Shqiperise me date 30 Qershor 2006, duke e paguar plotesisht kapitalin themeltar.

Pjeset e kapitalit themeltar ndahen si me poshte:

Emri i aksionerit	Kapitali ne Euro	Pjesa ne %	Numuri i aksioneve
1. Edmond LEKA	200.000 euro	2.5 %	1 - 20.000
2. Niko LEKA	200.000 euro	2.5 %	20.001-40.000
3. "Unioni Financiar Tirane" sh.p.k.	7.600.0000 euro	95.0 %	40.001- 800.000


Neni 8

Aksioneret themelues caktojne zoterinjte Gazmend KADRIA ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te Bankes dhe zotin Hans ABMA ne cilesine e N/Drejtorit te Pergjithshem te Bankes dhe i mandatojne ata te kryejne te gjitha procedurat e nevojshme ligjore per regjistrimin e shoqerise ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates te Shkalles te pare Tirane.

Neni 9

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", dhe dispozitat për katete të statutit të bankes, Banka drejtohet nga Këshilli Drejtues si organ përgjegjës, vendimor dhe mbikqyrës.

Këshilli i parë Drejtues përbëhet nga 5 (pese) anëtarë dhe do të jenë si më poshtë:





- | | | |
|----|-------------------|-----------|
| 1. | Edmond Leka | Kryetar |
| 2. | Niko Leka | N/Kryetar |
| 3. | Varuzhan Piranjan | Anëtar |
| 4. | Gazmend Kadriu | Anëtar |
| 5. | Teuta Baleta | Anëtare |

Neni 10

Komiteti i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve. Komiteti i parë i Kontrollit përbëhet nga një (1) kryetar plus dy (2) anëtarë si më poshtë:

- | | | |
|----|-------------------|---------|
| 1. | Varuzhan Piranjan | Kryetar |
| 2. | Neritan Kallfa | Anëtar |
| 3. | Florjon Mima | Anëtar |

Aksionerët themelues

Edmond LEKA

Niko LEKA

“Unioni Financiar Tirane” sh.p.k.

REPUBLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA

Nr. 2693 Rep.

Nr. 103 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten shtatembdhjete maj 2005 (dymije e pese),diten e marte, une notere **Eriketa Kokoli**, notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen "Kont Uran"Nr 20, vertetova firmen e : **Z. Edmond Leka**,i biri i Vlashit dhe i Margarites, lindur ne Tirane me 17.05.1963, banues ne Tirane, Rruga "Lidhja e Prizrenit" pall.12, shk.10, madhor dhe me zotesi te plote juridike, mbajtes i pasaportes me numer Z 0325057 si dhe **Niko Leka**, i biri i Vlashit dhe i Margatites, lindur ne Tirane me 31.03.1961, banues ne Tirane, Rruga " Sulejman Delvina " pall.29, shk.15 / 89, madhor dhe me zotesi te plote juridike, mbajtes i pasaportes me numer Z 0229907, te vene ne kete Akt Themelimi te Shoqerise " UNION BANK"SHA . Une noteri pasi e gjeta konform nenit 39 te Ligjes " Mbi Noterine " e vertetova si me poshte.



NOTER
NOTERE
ERIKETA KOKOLI

STATUTI

"UNION BANK" SH.A.

Themeluesit e shoqërisë tregtare "UNION BANK" sh.a. të mbledhur sot më 04/08/2004, për krijimin e kësaj shoqërie në përputhje me Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", Ligjin Nr.7667 datë 28.01.1993 "Për rregjistrin e shoqërive tregtare", si dhe Ligjin Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" hartuan, miratuan dhe firmosen Statutin e shoqërisë si më poshte:

KAPITULLI I

KRIJIMI-FORMA-KOHËZGJATJA-EMËRTIMI-OBJEKTI

Neni 1

Ortakët themelues të shoqërisë:

1. **Z. Edmond Leka**, i biri i Vlashit, lindur më 17.05.1963 në Tiranë, dhe banues po aty në Rr. "Lidhja e Prizerenit", Pall.12, Shk.10, Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës Nr.Z 0325057;
2. **Z. Niko Leka**, i biri i Vlashit, lindur më 31.03.1961 në Tiranë, dhe banues po aty në Rr. " Sulejman Delvina" , Pall.29, shk.15/89 Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës Nr.Z 0229907;
3. Shoqëria tregtare " **Unioni Financiar i Tiranes**" Sh.p.k, krijuar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.9406, datë 06.03.1995, përfaqësuar këtu në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve noterizuar me Nr.3717 Rep Nr. 1094 Kol dt.10.09.2004 nga Notere Eriketa Kokoli, nga **Z. Edmond Leka**, i biri i Vlashit, lindur më 17.05.1963 në Tiranë, dhe banues po aty në Rr. "Lidhja e Prizerenit", Pall.12, Shk.10, Tirane madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës Nr.Z 0325057;

vendosën krijimin e shoqërisë anonime pa ofertë publike me emërtimin:

"UNION BANK" sh.a. (këtu e me poshte vetem "Banka").

Banka është person juridik privat.

Statut i "UNION BANK" sh.a. doc.

Neni 2

Selia e bankës do të jetë ne Bl."Zogu I" Pallati 13 katesh, perballe me Stacionin e Trenit, Tiranë, Shqiperi.

Banka, me vendim të Këshillit Drejtues e me miratim nga Banka e Shqipërisë, mund të hapë filiale në të gjithë territorin e republikes se Shqipërisë si dhe jashtë territorit të Republikës se Shqipërisë.

Banka, me vendim të Këshillit Drejtues e me miratim nga Banka e Shqipërisë, mund të hapë degë, agjenci ose zyra përfaqësimi jashte territorit të Republikës se Shqipërisë.

Ne momentin e fillimit te veprimtarise Banka do ta ushtroje kete veprimtari ne degen e Tiranes.

Neni 3

Veprimtaria e Bankës në bazë të këtij Statuti është e pakufizuar në kohë.

Pervec rasteve te parashikuara ne Ligjin Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Banka mund të pushojë veprimtarine e saj edhe me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së bankës është përfshirja dhe kryerja në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë, e të gjitha veprimtarive (transaksioneve) bankare që janë të lejueshme ne perputhje me Ligjin Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ligjeve te tjera akteve normative të autoriteteve përkatëse të rregullimit të veprimtarisë bankare ne fuqi.

i. Në përputhje me liçensën e marrë nga Banka e Shqiperise, Banka ka të drejtë:

- a) të pranojë dhe të grumbullojë depozita bankare;
- b) të japë kredi;
- c) të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letra me vlerë të borxhit;
 - iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit, ose



- iv) instrumentet e normës së interesit;
- d) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- e) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
- f) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- g) të ushtrojë qiranë financiare;
- h) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
- i) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
- j) të shërbejë si agjente ose këshilltore financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikën 3/a dhe 3/b të nenit 26 të Ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë");
- k) të ushtrojë veprimtari të tjera bankare dhe financiare të përcaktuara me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë;
- ii. Në përputhje me liçensën e marrë, banka ka të drejtë të bëjë edhe këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) për këmbime valutore.
- iii. Në përputhje me liçensën e marrë, banka ushtron edhe:
 - a) shërbime besimi (trust), përfshirë pa kufizim, investim dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
 - b) shërbime si administruese e portofolit të investimit ose këshilltarit për investimet;
 - c) shërbime për nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve, sipas kufizimeve të parashikuara në nenin 33 të Ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Banka mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhenie apo hipotekimi, i cili vlerësohet i dobishëm apo i nevoshëm nga Drejtoria për arritjen e qëllimeve të Bankes. Gjithashtu Banka mund të kryejë aktivitete publikimi dhe të reklames, mund të nënshkruajë letra me vlerë dhe të leshojë garanci në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Banka ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo tjetër Shoqëri, brenda vendit ose jashtë vendit.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Neni 5

Kapitali themeltar eshte 8.000.000 euro (tete milion euro).
Kontributet per themelimin e shoqerise sillen ne para dhe depozitohen konform ligjit ne nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim, ne nje banke te nivelit te dyte, siç rezulton edhe nga certifikata eleshuar nga banka e perkatese, nga aksioneret themelues si me poshte:

Edmond LEKA	200.000	(dyqind mije euro)
Niko LEKA	200.000	(dyqind mije euro)
"Unioni Financiar Tirane" sh.p.k	7.600.000	(shtate milion e gjashteqind mije euro)

Kontributet jane te gjitha ne para dhe ne vleren prej 8.000.000 (tete milion euro).

Kapitali themeltar ndahet ne 800.000 (teteqind) aksione me vlere nominale 10 (dhjete) euro secili.

Themeluesit deklarojne se kapitali themeltar i percaktuar ne paragrafin e pare te ketij neni eshte neneshkruar dhe paguar prej tyre si me poshte:

- 7.000.000 (shtatemilion)euro ne momentin e paraqitjes te kerkeses per regjistrim ne gjykate.

• 1.000.000 (njemilion)euro ne perfundim te afatit limit te vendosur nga Banka e Shqiperise me date 30 Qershor 2006, duke e paguar plotesisht kapitalin themeltar.

Pjeset e kapitalit themeltar ndahen si me poshte:

Edmond LEKA	200.000 euro	2.5%	1 - 20.000
Niko LEKA	200.000 euro	2.5%	20.001-40.000

"Unioni Financiar Tirane" sh.p.k.	7.600.000 euro	95.00%
40.001- 800.000		

Neni 6

Aksionet janë nominative. Për aksionet do të lëshohen certifikata në bazë të ligjit, tipi i të cilave do të vendoset nga Këshilli Drejtues i cili do të përcaktojë personat që do të firmosin keto certifikata.

Në kohën e themelimit të shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj mund të krijohen aksione me përparësi që kanë avantazhe në raport me

të gjitha aksionet e tjera duke mbajtur parsysh edhe kërkesat e neneve 148 e 149 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 7

Aksionet janë të pandashme kundrejt Bankes, e cila njih vetëm një pronar të një aksioni. Çdo aksion jep të drejtën e një vote. Në rastin kur për një aksion ka më shumë se një zotërues, atëherë të drejtat e tyre duhet t'i ushtrojnë nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, por nëse nuk kanë caktuar përfaqësues, aksioni nuk përfaqësohet dhe ushtrimi i të drejtave që vijnë si pasojë e tij pezullohen.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetëm zotëruesi i tij i ligjshëm.

Aksionerët ushtrojnë të drejtat e tyre përsa i përket drejtimit të Bankës nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

Neni 8

Në rastin kur cilido aksioner dëshiron të transferojë një pjesë ose të gjitha aksionet e tij, me përjashtim të rasteve të trashgimisë, është i detyruar që përpara se t'i transferojë aksionet e Bankës tek persona të tretë t'ua ofrojë ato aksionerëve të tjerë. Aksionerët gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi aksionet e shoqërisë. Për këtë, aksioneri duhet të njoftojë me shkrim Këshillin Drejtues duke bërë të njohur numrin dhe vlerën (çmimin) e aksioneve. Këshilli Drejtues është i detyruar që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e lajmërimit përkatës të njoftojë me shkrim gjithë aksionerët e tjerë. Aksionerët e tjerë të Bankës brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit i bëjnë të njohur Këshillit Drejtues nëse do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo.

Në rast se me kalimin e këtij afati, aksionerët nuk njoftojnë ose bien dakort për shitjen e blerjen e aksioneve, atëherë aksioneri mund t'u drejtohet te tretteve jashtë shoqërisë për shitjen e aksioneve, me të njëjtin çmim që ua ka ofruar aksionerëve. Nëqoftëse shitja nuk realizohet me çmimin e ofruar dhe shitësi kërkon të ulë çmimin, atëherë ai në çdo rast që do të ulë çmimin, duhet të drejtohet më përpara tek aksionerët e Bankës e më pas të tretteve, derisa të realizohet shitja.

Në rastin e shitjes së aksioneve jashtë Bankës, shitësi duhet t'i paraqesë Bankës të dhëna të plota për aksionerin (aksionerët) e ri, si emri, mbiemri dhe adresa e personit që i transferohet pronësia.

Për vlerësimin e aksionerëve të rinj jashtë Bankës që do të blejnë aksionet e nxjerra për shitje, shoqëria do të kërkojë zbatimin e kërkesave që parashikon rregullorja "Për dhënien e liçensës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" për aksionerët themelues të bankave.

Pas plotësimit të kërkesave të mësipërme, shoqëria brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve njofton subjektet e interesuara për shitjen dhe blerjen e aksioneve.

Duke patur parasysh parashikimet e neneve 207 e 11 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", në çdo rast transferimi të aksioneve të një aksioneri ose blerjeje të tyre nga Banka, vlerësimi i tyre, në rast se palët e mësipërme nuk bien dakort, bëhet nga një ekspert. Eksperti caktohet nga palët. Kur ato nuk merren vesh midis tyre, ai caktohet nga gjykata.

Aksioni nominativ u transferohet të tretëve dhe personit juridik emetues sipas procedurave të përcaktuara në nenin 198 parag.2 dhe sipas rregullave të përcaktuara në nenin 197 parag.3 i Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Në rast se numri i aksionerëve të shoqërisë që interesohen për blerje aksionesh është më i madh se një, atëherë aksionerët e interesuar do të marrin aksione në përpjestim me numrin e aksioneve që zotërojnë.

Çdo transferim aksionesh që bëhet në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm dhe nuk sjell asnje pasoje juridike si për aksionerët ashtu edhe për Bankën.

Çdo ndryshim i aksionerit me pjesëmarrje influencuese në Bankë bëhet pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë.

NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 9

Kapitali Themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para në dorë, me kompensim të një kredie në para të kërkueshme dhe të detyruar për t'u shlyer nga shoqëria, me përfshirje të rezervave, fitimeve, primeve të emetimit, me kontribut në natyrë ose me shndërrimin e obligacioneve.

Zmadhimi i kapitalit nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve bëhet vetëm me pëlqimin unanimit të aksionarëve, me përjashtim të rastit kur ai realizohet me përfshirjen e rezervave, të fitimeve apo primeve të emetimit.

Në rastet e zmadhimit të kapitalit nëpërmjet kontributeve në natyrë zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 162, 168, 169 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme, që merret mbi bazën e raportit të Këshillit Drejtues, dhe ndryshimit të Statutit.

Në rast se zmadhimi i kapitalit realizohet me përfshirje të rezervave, të fitimeve ose primeve të emetimit, asambleja vendos sipas quorumit dhe të shumicës të kërkuar për Mbledhjet e Zakonshme të Asamblesë sipas nenit 129 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

SHLYERJA DHE VERIFIKIMI I KAPITALIT

Neni 10

Përpara se të kryhet çdo emetim aksionesh të reja që shlyhen me para në dorë, duhet që kapitali të jetë shlyer plotësisht, përndryshe operacioni konsiderohet i pavlefshëm.

Këshilli Drejtues në çdo rast të zmadhimit të kapitalit duhet që në një afat 3 (tre) muaj nga realizimi i zmadhimit të kapitalit të verifikojë depozitimin e kapitalit. Nëse aksioneri nuk ka shlyer shumat përkatëse mbi vlerën e aksioneve të nënshkruara prej tij brenda afatit të sipër përmendur, atëherë shoqëria përfaqësuar nga Këshilli Drejtues e paralajmëron fillimisht dhe nëse një muaj pas paralajmërimit shoqëria nuk ka përgjigje, ajo procedon me shitjen e aksioneve, në bazë të rregullave të nenit 208 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

ZVOGËLIM I KAPITALIT THEMELTAR

Neni 11

Zvogëlimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga Asambleja Jashtëzakonshme, pas miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë në përputhje me kërkesat e nenit 11 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Në Asamblesë e zakonshme që thirret për zvogëlimin e kapitalit dorëzohet raporti i arsyetuar i Këshillit Drejtues duke shpjeguar arsyet që bëjnë të detyrueshme marrjen e vendimit përkatës.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek aksionarët në të njëjtën masë në përpjestim me vlerën e aksioneve që zotërojnë, sipas përcaktimit të nenit 164 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së zakonshme që thirret për të vendosur mbi këtë projekt.

Asambleja merr vendim mbi raportin e ekspertëve kontabël të autorizuar, të cilët japin vlerësimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogëlimit.

KAPITULLI III

ORGANET E BANKËS

ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME

Neni 12

Asambleja e Aksionerëve është organi më i lartë vendimmarrës i Bankës.

Vetëm Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve ka të drejtën e ndryshimit të statutit, në lidhje me gjithë dispozitat e tij.

Çdo parashikim që bie në kundërshtim me këtë përcaktim është i pavlefshëm.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të marrë vendime të vlefshme në rast se të pranishmit ose aksionarët e perfaqësuar përbëjnë të paktën 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit aksionar, gjatë mbledhjes së saj të parë. Në rast se nuk ekziston shumica e duhur e mësipërme, Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të

shtyhet për një ditë tjetër por, jo më shumë se 2 (dy) muaj nga dita e mbledhjes së parë, dhe mund të mbledhet pasi janë të pranishëm aksionerët ose përfaqësuesit e tyre dhe që përfaqësojnë 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit aksionar.

Vendimet e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve merren me një shumicë votash prej tre të katërtat (¾) që u përkasin aksionerëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

Neni 13

Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve merr çdo vendim, përveç atyre që përmenden shprehimisht në nenin 128 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve vendos për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Bankën. Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm nëse aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën ¼ (një të katërtën) e aksioneve me të drejtë vote. Në rast të mos arritjes së këtij quorumi në mbledhjen e parë, në mbledhjen e dytë që do të thirret brenda afatit kohor të 1 (një) muaji nuk kërkohet asnjë lloj quorumi.

Vendimet e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve merren me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët pjesmarrës ose të përfaqësuar.

Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve thirret në mbledhje të paktën 1 (një) herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar. Ky afat mund të zgjatet me vendim gjyqësor.

Asambleja shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet e vitit financiar që u mbyll. Ajo ushtron kompetencat që ka në bazë të neneve 19 pika 2 e 3 dhe nenit 20 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" si dhe neneve 123 dhe parag. 3 i nenit 125 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Këshilli Drejtues ose nga Drejtoria.

Në mungesë të tyre do të thirret nga:

- 1) Nga ekspertët kontabël të autorizuar.

2) Nga një mandatmbajtës i caktuar nga gjykata, me kërkesën e çdo personi të interesuar për një rast urgjent të një ose disa aksionerëve që zotërojnë së bashku të paktën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themelor

3) Nga likuidatorët.

Mbledhja e Asamblesë të Aksionerëve mbahet si rregull në selinë e shoqërisë, nqs nuk parashikohet ndryshe ne njoftimin e thirrjes nga organi perkates.

Neni 15

Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së zakonshme të aksionerëve bëhet nëpërmjet një njoftimi që dërgohet me letër rekomande në adresën e çdo aksioneri. Njoftimi duhet të merret prej aksionerëve apo të njihet prej tyre, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së asamblesë. Njoftimi përcakton ditën, orën dhe vendin ku mbahet mbledhja, si dhe rendin e ditës.

Çdo mbledhje asambleje që thirret në mënyrë të parregullt, mund të anulohet.

Megjithatë veprimi i anulimit nuk pranohet, kur të gjithë aksionerët janë të pranishëm apo të përfaqësuar.

Neni 16

Rendi i ditës i mbledhjeve të asamblesë së aksionerëve përcaktohet nga organi që thërret mbledhjen. Megjithatë një apo disa aksionerë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit, u njihet e drejta për të futur në rend të ditës disa projektrezoluta sipas procedurave të përcaktuara në nenin 134 parag. 3 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Asambleja nuk mund të shqyrtojë një çështje që nuk përcaktohet në rendin e ditës. Megjithatë ajo mund të shkarkojë një apo disa anëtarë të Këshillit Drejtues apo Këshillit Administrativ dhe të procedojë për zëvendësimin e tyre në çdo rrethanë.

Rendi i ditës së Asamblesë nuk mund të ndryshohet me lajmërim të dytë.

Neni 17

Çdo aksioner mund të përfaqësohet vetëm nga një aksioner tjetër ose nga bashkëshorti, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 135 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 18

Këshilli Drejtues është i detyruar të vërë në dispozicion të aksioneve, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dokumentacionin që përcaktohet nga neni 136 i Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", sipas procedurës që parashikohet në këtë nen.

Neni 19

Aksionerët që duan të marrin pjesë në Asamble duhet që deri 5 (pesë) ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë të kenë kryer rregjistrimin e tyre si aksionere në regjistrin e aksioneve nominative të Bankës.

Neni 20

Në rast se një aksion i takon më shumë se një personi, për çdo shkak dhe arsye, ata janë të detyruar të përcaktojnë përfaqësuesin e tyre të përbashkët, i cili do të ushtrojë të drejtat e tyre aksionere në përgjithësi.

Neni 21

Anëtarët e Këshillit Drejtues, të Komitetit të Kontrollit, të Drejtorisë dhe ekspertët kontabël të autorizuar mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së zakonshme me vota konsultative. Ata kanë votë vendimore kur kanë cilësinë e aksionerit.

Neni 22

Në çdo mbledhje të Asamblesë plotësohet një evidencë pjesëmarrjeje, sipas kërkesave të parashtruara në nenin 49 të Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 "Për rregjistrin e shoqërive tregtare". Ecuria e mbledhjeve pasqyrohet në procesverbal që mbahet siç përcaktohet në nenin 50 të Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 "Për rregjistrin e shoqërive tregtare".

Neni 23

Mbledhjet e Asamblesë drejtohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe kur mungon ai, drejtohen nga nënkryetari.

Në rast thirrje të asamblesë nga ekspertët kontabël të autorizuar, nga një mandatmbajtës i caktuar nga gjykata ose nga likujduesit, mbledhja e Asamblesë drejtohet nga personi ose njëri prej personave që e kanë thirrur këtë mbledhje. Drejtuesi i Asamblesë cakton sekretarin, i cili mund të mos jetë aksioner.

Neni 24

Duke filluar që nga momenti i njoftimit të thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Zakonshme vjetore, çdo aksioner ose përfaqësuesi i tij që do ta përfaqësojë në asamble, ka të drejtë që në selinë e Bankës të informohet për të gjitha çështjet që parashikohen në nenin 143 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe sidomos për këto:

- Inventarin, bilancin financiar vjetor dhe listën e anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- Raportet e Këshillit Drejtues dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar, që do t'i paraqiten asamblesë për shqyrtim;
- Shumën e saktë të shpërblimit që marrin personat e mësipërm.

Neni 25

Çdo aksioner ka të drejtë të informohet ose të marrë kopje të listës së aksionerëve dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Bankës 15 (pesëmbëdhjetë) ditë më parë se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 26

Çdo aksioner ka të drejtë në çdo kohë që të kërkojë t'i vihen në dispozicion dokumentat e shoqërisë të përmendura në nenin 24, për 3 (tre) vjetët e fundit financiarë, si dhe procesverbalet dhe evidencat e pjesmarrjes së mbledhjeve të asamblesë të zhvilluara në 3 (tre) vitet e fundit.

Neni 27

Në rast se banka refuzon pjesërisht apo krejtësisht të drejtën e aksionerit për t'u informuar, e drejtë që i jepet nga nenet e mësipërme, aksioneri që konsideron se preket nga ky veprim ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës.

Neni 28

E drejta e votës që rrjedh nga zotërimi i aksioneve është proporcionale me pjesën e kapitalit që ato përfaqësojnë dhe çdo aksioner jep të drejtën e të paktën një vote.

Neni 29

Aksionerët të cilët përfaqësojnë 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit të paguar kanë mundësi të thërrasin Asambleshë e zakonshme dhe përcaktuar dhe çështjet e rendit të ditës. Këshilli Drejtues është i detyruar të thërrasë Asambleshë e zakonshme të kërkuar, përveç rastit kur ka një arsye shumë të rëndësishme. Aksionerët që përbëjnë të paktën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit aksioner mund t'i drejtohen gjyqit për të kërkuar kontrollin e ekzistencës së arsyes së rëndësishme dhe thirrjen e asamblesë me vendim gjykate.

Me kërkesë të aksionerëve që përfaqësojnë të paktën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit të paguar, Kryetari i Asamblesë ka mundësi të anullojë për një herë të vetme marrjen e vendimit të Asamblesë së Zakonshme ose të Jashtëzakonshme duke përcaktuar njëkohësisht dhe ditën e mbledhjes për marrjen e vendimit, ditë e cila nuk mund të jetë 30 (tridhjetë) ditë më pas nga dita e anulimit të mbledhjes së parë.

KËSHILLI DREJTUES

Neni 30

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", Banka drejtohet nga Këshilli Drejtues si organ përgjegjës, vendimor dhe mbikqyrës.

Këshilli Drejtues është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave, si dhe për mbikqyrjen e veprimtarisë së Bankës. Për këtë ai përpunon e miraton aktet e brendshme të bankës që përcaktojnë:

- a) strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të Bankës, duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, funksionet e tyre, pozicionet mbikqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese;
- b) detyrat e çdo drejtori dhe të njësive që ai drejton e mbikqyr;
- c) funksionet e Komitetit të Kontrollit dhe të komiteteve të tjera të brendshme të përhershme;
- d) kufijtë e kompetencave të administratorëve dhe të punonjësve të tjerë të Bankës që do të kryejnë veprimtari financiare në emër dhe për llogari të Bankës.

Këshilli Drejtues është kompetent të vendosë për çdo çështje që ka të bëjë me drejtimin e Bankës, administrimin e pasurisë së saj dhe në përgjithësi në arritjen e qëllimeve të saj. Këshilli Drejtues nuk ka të drejtë të marrë vendim për çështje që janë në kompetencat e Asamblesë së zakonshme. Ai jep llogari përpara Asamblesë dhe paraqet raportin vjetor për veprimtarinë e vet.

Neni 31

Këshilli Drejtues përbëhet nga një numer tek anëtarësh, jo më pak se 5 (pesë).

Anëtarët e Këshillit zgjidhen nga Asambleja e zakonshme e Aksionerëve.

Këshilli i parë Drejtues përbëhet nga 5 (pese) anëtarë dhe do të jenë si më poshtë:

- | | |
|----------------------|-----------|
| 1. Edmond Leka | Kryetar |
| 2. Niko Leka | N/Kryetar |
| 3. Varuzhan Piranjan | Anëtar |
| 4. Gazmend Kadriu | Anëtar |
| 5. Teuta Baleta | Anëtare |

Neni 32

Asambleja e zakonshme mund të zgjedhë si anëtarë të Këshillit Drejtues edhe individë jashtë bashkësisë së aksionerëve. Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk kanë përgjegjësi personale kundrejt të tretëve dhe kundrejt aksionerëve të Bankës, por kanë përgjegjësi kundrejt personit juridik të shoqërisë për detyrat që u janë ngarkuar.

Këshilli Drejtues zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin e tij. Kryetari kryeson mbledhjen dhe në mungesë të tij, zëvendësohet nga nënkryetari.

Neni 33

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues caktohet për një periudhë 4 (kater) vjeçare e cila shtyhet deri në mbledhjen e Asamblesë së zakonshme që do të miratojë tabelat financiare (rezultatet) e vitit financiar që u mbyll dhe Asambleja e zakonshme do të mbledhet detyrimisht brenda gjashtë mujorit të parë nga mbyllja e vitit financiar. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen për periudha vijuese.

Në rast vdekjeje, shkarkimi nga detyra ose të mungesës të pajustificuar të një anëtari të Këshillit Drejtues nga mbledhjet për tre muaj rresht, Këshilli Drejtues mund të zgjedhë zëvendës të tij deri në mbledhjen e parë të Asamblesë së zakonshme.

Këshilli Drejtues thirret në mbledhje nga Kryetari dhe në rast se ai nuk ka mundësi ose mungon, thirret nga nënkryetari ose në raste të jashtëzakonshme me kërkesë të të paktën 2 (dy) anëtarëve të

Këshillit, dhe vendimet merren me shumicë absolute votash të të pranishmeve dhe të votave të përfaqësuara (neni 118, L.7638/92). Këshilli Drejtues ka qorum dhe quhet i mbledhur ligjërisht kur në të janë të pranishëm ose përfaqësohen të paktën gjysma plus një e numrit të anëtarëve të tij.

Anëtari i Këshillit Drejtues që mungon mund të përfaqësohet në mbledhjen e Këshillit Drejtues vetëm nga një prej anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 34

Për diskutimet që bëhen dhe për vendimet që merren, mbahet procesverbal i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm. Në procesverbal shënohen edhe mendimet e atyre që nuk janë dakort.

Këshilli Drejtues mund të delegojë me shkrim përfaqësimin e Bankës ose dhe të disa kompetencave të tij tek një ose më shumë anëtarë të tij ose tek të tretë, duke përcaktuar njëkohesisht dhe kompetencat që u jep.

Për anëtarët e Këshillit Drejtues jepet shpërblim i cili përcaktohet me vendim të Asamblesë së zakonshme të Aksionerëve.

DREJTORIA

Neni 35

Asambleja e aksionereve zgjedh Drejtorinë e shoqërisë që përbëhet nga një Drejtor i Përgjithshëm, Z/V Drejtor i Përgjithshëm dhe 5 drejtorë departamentesh.

Drejtori i Përgjithshëm mund të shkarkohet sipas nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Kohëzgjatja e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm caktohet për një periudhë 2 vjeçare

Mënyra dhe masa e shpërblimit të Drejtorit të Përgjithshëm caktohen në aktin e emërimit.

Neni 36

Drejtoria ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të Bankës.

Banka në marrëdhënie me të tretët merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e Drejtorisë edhe kur këto akte nuk përfshihen në objektin e Bankës, përveç kur Drejtoria ka vepruar me keqbesim dhe në dëm të Bankës si dhe të tretët kishin dijeni se Keshilli ishte në tejkalim të kompetencave të tij në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson Bankën në marrëdhënie me të tretët.

Drejtori i parë i Përgjithshëm i bankës do të jetë: **Z. Gazmend Kadriu.**

Nen/Drejtori i përgjithshëm i bankës do të jetë : **Z.Hans Abma**

KOMITETI I KONTROLLIT

Neni 37

Komiteti i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve.

Komiteti i parë i Kontrollit përbëhet nga një (1) kryetar plus dy (2) anëtarë si më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Varuzhan Piranjan | Kryetar |
| 2. Neritan Kallfa | Anetar |
| 3. Florjon Mima | Anetar |

Neni 38

Kompetencat e Komitetit të Kontrollit janë këto:

- a) Kontrollon dhe mbikqyr procedurat kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të Bankës, duke përfshirë procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, si dhe mbikqyr zbatimin e këtyre procedurave dhe kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse.

- b) Kontrollon zbatimin e rregulloreve e të akteve të tjera dhe i raporton Këshillit Drejtues të Bankës.
- c) Jep mendime për të gjitha problemet që i kërkohen nga Këshilli Drejtues i Bankës.

Komiteti i Kontrollit mbledhet jo më pak se tre herë në vit në mbledhje të zakonshme dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga Këshilli Drejtues i Bankës. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Abstenime nuk lejohen.

Komiteti i Kontrollit ka mundësi, me kërkesën e tij, të ndihmohet në punë nga ekspertë të cilët do të emërohen nga Këshilli Drejtues, në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Komiteti i Kontrollit jep llogari dhe raportin përpara Asamblese së Aksionereve.

Dhënia e shpërblimit për anëtarët e Komitetit të Kontrollit vendoset nga Asambleja e Aksionerëve të Bankës.

Neni 39

Për ndërmarrjen e veprimeve të anëtarëve të Këshillit Drejtues, të Këshillit Administrativ dhe të anëtarëve të Komitetit të Kontrollit, zbatohen nenet 122-127 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

KAPITULLI VI

KONTROLI I BANKËS

EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

Neni 40

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme emëron ekspertin kontabël të autorizuar sipas dispozitave të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të licensuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

Ekspertët kontabël të autorizuar duhet:

- a) të ndihmojnë për mbajtjen në mënyrën e duhur të llogarive kontabel dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë;
- b) të përgatitin raportin vjetor së bashku me opinionet e kontrollit, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të

gjendjes financiare të Bankës, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga Banka në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare në zbatim të dispozitave të ligjit N.8365/98;

- c) të shqyrtojnë mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe të praktikave e procedurave kontrolluese, si dhe të bëjnë rekomandimet përkatëse.

Ekspertët kontabël të autorizuar garantojnë që llogaritë vjetore janë të rregullta e të hartuara me vertetesi dhe japin një pasqyrim besnik të rezultatit të operacioneve të vitit të kaluar financiar, si dhe të gjendjes financiare të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti financiar. Gjithashtu, ata kanë detyrë të përhershme, duke përjashtuar çdo ndërhyrje në administrim, të verifikojnë librat e llogarisë dhe fondet e shoqërisë, si dhe të kontrollojnë përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi. Ata verifikojnë gjithashtu vertetësinë dhe përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna në raportin e administrimit nga ana e Këshillit Drejtues dhe në dokumentet që u janë dërguar aksionerëve mbi gjendjen financiare dhe llogaritë vjetore.

Ekspertët kontabël të autorizuar sigurohen që është respektuar barazia ndërmjet aksionerëve.

Për përmbushjen e detyrave të tyre ekspertët kontabël të autorizuar kanë të drejtë të kryejnë të gjitha verifikimet e kontrollet e parashikuara në nenin 179 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 41

Ekspertët kontabël të autorizuar i bëjnë të njohur Këshillit Drejtues:

1. Kontrollet dhe verifikimet që kanë kryer dhe sondazhet e ndryshme që kanë bërë;
2. Pjesët e bilancit dhe të dokumentave të tjera të kontabilitetit në të cilat sipas tyre duhet të ishin bërë ndryshime, duke bërë gjithashtu edhe të gjitha vërejtjet e duhura mbi metodat e vlerësimit të përdorura në përpilimin e këtyre dokumentave;
3. Parregullshmëritë dhe pasaktësitë që kanë zbuluar;
4. Përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigjimet e mësipërme mbi rezultatet e vitit financiar, të krahasuara me ato të vitit financiar të mëparshëm.

Ekspertët kontabël të autorizuar informojnë Këshillin Drejtues dhe Bankën e Shqipërisë për çdo veprim mashtrues të kryer nga nëpunësi i Bankës, si dhe për çdo parregullsi dhe mangësi në administrim ose në transaksionet që mund t'i sjellin humbje Bankës.

Gjithashtu, ata sinjalizojnë në mbledhjen më të afërt të asamblesë parregullshmëritë dhe pasaktësitë e gjetura nga ata gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

Neni 42

Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen për një vit financiar. Funkcionet e tyre përfundojnë pas Mbledhjes së Asamblesë së Zakonshme, e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore.

Një ose disa aksionerë që përfaqësojnë të paktën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar, kanë mundësi, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e caktimit, të kundërshtojnë në gjykatë një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar të caktuar në mbledhjen e asamblesë dhe të kërkojnë emërimin e një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar që do të ushtrojnë funksionet në vend të tyre. Në qoftë se kërkesa konsiderohet e drejtë, caktohet nga gjykata një ekspert kontabël i ri.

Per vitin e pare financiar te ushtrimit te veprimtarise se Bankes ekspert kontabel i autorizuar emerohet Deloitte & Touche .

Neni 43

Banka mban në zyrat e saj librat që kërkohen nga legjislativori në fuqi, ku do të mbahen llogaritë vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore, raportet ekonomike vjetore, në të cilat duhet të përfshihet dhe çdo gjë tjetër që parashikohet nga ligji.

Neni 44

Viti financiar ka kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor të çdo viti. Përfshihet viti i parë financiar që fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë në gjykatë dhe mbaron me 31 Dhjetor 2005

Në fund të çdo viti financiar Këshilli Drejtues harton bilancin dhe llogaritë vjetore në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi për kontabilitetin, si dhe përpilon raportin vjetor të administrimit.

REZERVA E DOMOSDOSHME

Neni 45

Banka nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur po të jetë e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, lë mënjanë një shumë me vlerë të paktën 1/20 (një të njëzetën) e tij, e cila destinohet për formimin e një fondi rezervë, të quajtur "reservë e domosdoshme". Kjo procedurë pushon së qeni e detyrueshme kur shuma e rezervës së domosdoshme arrin masën e 1/10 (një të dhjetës) së kapitalit të paguar.

NDARJA E FITIMEVE DHE PËRCAKTIMI I DIVIDENTËVE

Neni 46

Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së shumave që mund të shpërndahen, Asambleja e Përgjithshme, përcakton nese do të shpërndajë fitimin në forme dividendesh për aksioneret dhe nese po, përcakton pjesën e fitimit që u takon aksionerëve në formë dividendësh, në bazë të neneve 215, 216 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

KAPITULLI V

PERFUNDIMI I AKTIVITETIT TE BANKËS

Neni 47

Perfundimi i aktivitetit të Bankës vendoset nga Mbledhja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve.

Banka e perfundon aktivitetin e saj në këto raste:

- 1) me përfundimin e afatit të kohëzgjatjes së veprimtarisë së saj;
- 2) në rast humbje të aktivitetit;
- 3) me shpalljen e falimentimit;
- 4) kur një gjë e tillë është vendosur nga Banka e Shqipërisë në zbatim të neneve 13, 48, 49, 50 dhe 51 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
- 5) për çdo shkak tjetër që Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve e gjen të arsyeshme të marrë një vendim të tillë.

KUJDESTARIA DHE LIKUIDIMI

Neni 48

Në rastet e parashikuara në nenin 48 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë mund të vendosë bankën në kujdestari, sipas procedurave dhe kompetencave të percaktuara në nenet 48, 49 e 50 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 49

Banka është në likuidim që në momentin e perfundimit të veprimtarisë së saj për çdo lloj arsye, me përjashtim të rastit të nenit 10 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Banka vendoset në likuidim nga Banka e Shqipërisë, në rastet e percaktuara në nenin 51 të Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Emërtimi i bankës në stadin e likuidimit, pasohet nga shënimi "Shoqëri në likuidim e sipër".

Ky tregues si dhe emri i likuiduesit duhet të shënohen në të gjitha veprimet dhe dokumentat që lëshon Banka tek të tretët.

Likuidimi i bankës bëhet në bazë të dispozitave që percaktohen në Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligjin Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

KAPITULLI VI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 50

Për çështjet që nuk parashikohen nga statuti i Bankës dhe gjate periudhës së themelimit të Bankës zbatohen dispozitat në fuqi të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 "Për rregjistrin e shoqërive tregtare", si dhe Ligjit Nr.8365 datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

KAPITULLI VII
DISPOZITAT E FUNDIT
MBULIMI I KAPITALIT AKSIONER

Neni 51

Kapitali Aksioner mbulohet si më poshtë:

Emri aksionerit	Nr. Aksioneve	Pjesmarrja (euro)	Pjesmarrja (përqindje)
Unioni Financiar Tirane sh.p.k.	760.000	7.600.000	95
Edmond Leka	20.000	200.000	2,5
Niko Leka	20.000	200.000	2,5

Neni 52

Emri i Bankës do të jetë "UNION BANK" sh.a i cili pasqyrohet edhe në vulën e saj.

Neni 53

Ky Statut hartohet në 5 (pesë) kopje dhe pasi nënshkruhet me vullnetin e lirë të palëve përpara noterit, do të depozitohet një kopje në Noterinë e Tiranës, një kopje në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, një kopje pranë Organeve Tatimore të Rrethit Tiranë, një kopje në Bankën e Shqipërisë dhe një kopje mbahet pranë shoqërisë.

Neni 54

DISPOZITA E FUNDIT

Kjo Bankë do të fillojë të ushtroje veprimtarinë e saj pasi të jetë miratuar fillimi i kryerjes së veprimtarisë së saj nga autoritetet përkatëse shqiptare, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe vetëm me plotësimin e këtij kushti.

Ky statut hyn në fuqi datën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar.

AKSIONERËT THEMELUES

1. "Unioni Financiar Tirane" sh.p.k. Kompani

Edmond Leka

2. Edmond Leka Individ

Edmond Leka

3. Niko Leka Individ

Niko Leka